

NJIHNI TË DREJTAT TUAJA

Keni të drejtë të votoni në një zgjedhje të përgjithshme ose zgjedhje të posaçme nëse:

- Jeni një votues i regjistruar.
- Jeni brenda ose në radhë në vendvotimin tuaj midis orës 6:00 të mëngjesit dhe 9:00 të mbrëmjes në Ditën e Zgjedhjeve, ose votoni herët.

Keni të drejtë të votoni në një zgjedhje paraprake nëse:

- Jeni një votues i regjistruar dhe jeni i regjistruar në një parti që zhvillon zgjedhje paraprake, përveç nëse rregullat e partisë në nivel shteti lejojnë ndryshe.
- Jeni brenda ose në radhë në vendvotimin tuaj midis orës 6:00 të mëngjesit dhe 9:00 të mbrëmjes në Ditën e Zgjedhjeve, ose votoni herët.

Keni të drejtë të votoni herët. Votimi i hershëm do të zhvillohet për nëntë ditë radhazi përpara çdo Dite të Zgjedhjeve, duke filluar 10 ditë përpara Ditës së Zgjedhjeve. Gjithashtu mund të votoni në Ditën e Zgjedhjeve.

Për të mësuar se ku të votoni herët ose në Ditën e Zgjedhjeve, vizitoni [vote.nyc](https://www.vote.nyc). Vendvotimi juaj për votim të hershëm mund të jetë i ndryshëm nga vendvotimi juaj në Ditën e Zgjedhjeve.

Në çdo zgjedhje, keni të drejtë të:

- Të ndihmoheni nga çdo person sipas zgjedhjes suaj (përveç punëdhënësit tuaj ose përfaqësuesit të sindikatës), përfshirë një punonjës të trajnuar të qendrës së votimit, nëse keni nevojë për ndihmë për të votuar

Nëse keni nevojë për një përkthyes, përkthyesit janë të disponueshëm për të ndihmuar votuesit në disa qendra të përzgjedhura.

- **Telefononi në 866-VOTE-NYC për më shumë informacion, përfshirë cilat qendra votimi kanë përkthyes të disponueshëm në spanjisht, kinezçe (kantoneze dhe mandarine), koreane, bangla, punxhabi dhe hindi.**
- **Vizitoni on.nyc.gov/vla për të parë se ku janë të disponueshëm përkthyesit e Komisionit për Angazhimin Qytetar të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Civic Engagement Commission) në gjuhë të tjera.**

- Sillni një përkthyes me vete në kabinën e votimit.
- Pyesni punonjësit e zgjedhjeve se si të shënoni dhe të hidhni votën tuaj.
- Sillni me vete materiale rreth kandidatëve dhe çështjeve në fletën e votimit, si p.sh. Udhëzuesi i Votuesit të Bordit të Financimit të Fushatave (Campaign Finance Board, CFB). (Ju lutemi merrni këto materiale me vete kur të përfundoni votimin.)
- Votoni edhe nëse makineria e votimit është e prishur.
- Votoni me “fletë votimi me deklaratë” (affidavit ballot) nëse emri juaj mungon nga lista e votuesve në qendrën tuaj të votimit.
- Merrni leje nga puna për të votuar: Ligji i Shtetit të Nju Jorkut ju lejon të merrni deri në tre orë të paguara në fillim ose në fund të turnit tuaj për të votuar, për sa kohë që njoftoni punëdhënësin tuaj të paktën dy ditë përpara Ditës së Zgjedhjeve.
- Sipas ligjit federal dhe atij shtetëror, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për ndihmë me regjistrimin si votues, qendra votimi të aksesueshme dhe ndihmë për hedhjen e votës së tyre. Nëse keni një aftësi të kufizuar dhe besoni se ju është mohuar e drejta për ndihmë gjatë votimit ose regjistrimit si votues, ju lutemi telefononi 311.
- Nëse aktualisht jeni në provë ose në lirim me kusht, keni të drejtë të votoni. Nëse keni qenë më parë të regjistruar, të dhënat tuaja si votues duhet të jenë ende aktive. **Kontrolloni statusin e regjistrimit tuaj si votues në: voterlookup.elections.ny.gov/**

Nëse votoni për herë të parë, mund t’ju duhet të paraqisni një dokument identifikimi për të votuar në këto zgjedhje.

- Format e pranueshme të identifikimit përfshijnë një dokument identifikimi me fotografi të vlefshëm ose një faturë aktuale shërbimesh, ekstrakt bankar, çek qeveritar ose pagesë, ose dokument qeveritar që tregon emrin dhe adresën.
- Nëse nuk mundeni ose zgjidhni të mos paraqisni identifikim, keni të drejtë të votoni me “fletë votimi me deklaratë”.

HEDHJA E VOTËS SUAJ


Tre hapa të thjeshtë për të hedhur votën tuaj në Ditën e Zgjedhjeve ose gjatë Votimit të Hershëm:

1 | Merrni fletën e votimit

- Shkoni në qendrën tuaj të caktuar të votimit dhe gjeni tavolinën e duhur për Distriktin tuaj të Asamblesë/Distrikthin Zgjedhor (këto numra janë të shtypur në njoftimin që merrni nga Bordi i Zgjedhjeve (Board of Elections) dhe në etiketën postare të Udhëzuesit të Votuesit) ose në findmypollsite.vote.nyc/.
- Regjistrohuni dhe merrni fletën tuaj të votimit në letër nga punonjësi i qendrës së votimit. Do t'ju jepet një mbështjellëse privatësie për të mbuluar fletën e votimit pasi ta keni plotësuar. Të dyja anët e fletës së votimit do të kenë udhëzime në pjesën e sipërme.
- Shkoni në kabinën e privatësisë ose kërkonte të përdorni Pajisjen për Shënimin e Fletës së Votimit (Ballot Marking Device) nëse keni nevojë për ndihmë për të plotësuar zgjedhjet tuaja.

2 | Shënoni fletën e votimit

- Në zgjedhjet paraprake dhe të përgjithshme për zyrat jashtë qyteteve, votoni duke plotësuar kutinë pranë kandidatit tuaj të preferuar.
 - Shënoni fletën e votimit duke nxirë plotësisht hapësirën e ovalit pranë zgjedhjes suaj duke përdorur stilolapsin e dhënë.



- MOS përdorni një "x" ose një "✓", mos rrethoni hapësirën e ovalit dhe mos bëni shenja të rastësishme në fletën e votimit.
 - Për një kandidat të shkruar manualisht, plotësoni hapësirën e ovalit përkatës dhe shkruani emrin e kandidatit.
 - Kthejeni fletën e votimit për të parë nëse ka zgjedhje shtesë në pjesën e pasme.
 - MOS e palosni fletën e votimit.
 - MOS nënshkruani ose shkruani emrin tuaj në fletën e votimit.
- Në një zgjedhje paraprake për **disa zyra të qytetit**, NYC përdor **Votim me Renditje sipas Preferencës**. Ana e fletës së votimit për **Votimin me Renditje sipas Preferencës** mund të përfshijë garat e mëposhtme: Kryetar Bashkie, Avokat i Pipullit, Kontrollor, President i Borough-it dhe Këshilli i Qytetit.
 - Mund të renditni deri në 5 kandidatë sipas preferencës.
 - Zgjidhni kandidatin tuaj të parë dhe plotësoni plotësisht hapësirën e ovalit përkatës në kolonën e parë.
 - Nëse ju pëlqen më shumë se një kandidat, plotësoni hapësirat e ovalit përkatës për deri në pesë zgjedhje.
 - Mund të zgjidhni gjithashtu të votoni vetëm për një kandidat nëse preferoni. Renditja e kandidatëve të tjerë nuk e dëmton zgjedhjen tuaj të parë.

	1	2	3	4	5
KANDIDATI A	☐	☐	☒	☐	☐
KANDIDATI B	☒	☐	☐	☐	☐
KANDIDATI C	☐	☒	☐	☐	☐
KANDIDATI D	☐	☐	☐	☒	☐
KANDIDATI E	☐	☐	☐	☒	☐

- MOS e renditni një kandidat më shumë se një herë. Nëse e bëni, vetëm renditja juaj më e lartë për të do të merret në konsideratë.
- MOS u jepni disa kandidatëve të njëjtën renditje. Nëse zgjidhni më shumë se një kandidat si zgjedhjen tuaj të parë, fleta juaj e votimit nuk do të jetë e vlefshme.

	1	2	3	4	5
KANDIDATI A	☐	☐	☐	☒	☐
KANDIDATI B	☒	☐	☐	☐	☐
KANDIDATI C	☒	☐	☐	☐	☐
KANDIDATI D	☐	☒	☐	☐	☐
KANDIDATI E	☐	☐	☒	☐	☐

- Ana e fletës së votimit për **Votim pa Renditje sipas Preferencës** mund të përfshijë garat e mëposhtme: Prokuror i Distriktit, Komiteti Shtetëror, Gjyqtar i Gjykatës Civile (Distrikt ose Qark), Drejtues i Distriktit, Delegat në Konventën Gjyqësore.
- **Votimi i shkruar manualisht:** Nëse dëshironi të votoni për një kandidat që nuk është i listuar në fletën e votimit, duhet:
 - Të plotësoni plotësisht hapësirën e ovalit në zonën e parashikuar për kandidatët e shkruar manualisht, dhe
 - Të shkruani ose vulosni emrin e kandidatit në të njëjtën kuti.
- Kërkoni të përdorni **Pajisjen për Shënimin e Fletës së Votimit** nëse keni nevojë për ndihmë për të plotësuar zgjedhjet tuaja.
 - Pajisja për Shënimin e Fletës së Votimit ofron dy mënyra që votuesit të aksesojnë fletën e votimit:
 - Duke parë fletën e votimit në ekran.
 - Duke dëgjuar fletën e votimit nëpërmjet kufjeve audio.
 - Pajisja për Shënimin e Fletës së Votimit ofron katër mënyra që votuesit të plotësojnë fletën e votimit:
 - Ekran me prekje.
 - Tastierë (Braille).
 - Pajisje Thith & Fry.
 - Levë me dy drejtime.
 - Ndiqni këto hapa për të plotësuar fletën e votimit duke përdorur Pajisjen për Shënimin e Fletës së Votimit:
 - Vendosni se si do ta aksesoni dhe plotësoni fletën e votimit.
 - Vendosni fletën e votimit tek vendi i futjes së fletëve.
 - Zgjidhni gjuhën tuaj të preferuar.
 - Pajisja për Shënimin e Fletës së Votimit do t’ju udhëheqë gjatë procesit të zgjedhjes dhe rishikimit të përzgjedhjeve tuaja.
 - Për të ndryshuar një zgjedhje, zgjidhni garën ose çështjen që dëshironi të ndryshoni dhe zgjidhni sërish opsionin e duhur. Zgjidhni “NEXT” (VAZHDO) për t’u kthyer në ekranin përmbledhës.
 - Zgjidhni “Mark Ballot” (Shënoni Fletën e Votimit) për të printuar fletën tuaj të votimit të plotësuar.
 - Çojeni fletën tuaj të printuar të votimit dhe kartën e votuesit në zonën e skanimit.
 - Nëse dëshironi ndihmë për vendosjen e fletës së votimit në skaner, do t’ju ndihmojë një punonjësi i qendrës së votimit.

3 | Skanoni fletën e votimit

- Mbajeni fletën tuaj të votimit të plotësuar në mbështjellësen e privatësisë dhe çojeni në zonën e skanimit.
- Zgjidhni gjuhën tuaj të preferuar duke prekur butonin përkatës në ekran.
- Vendosni fletën tuaj të votimit të plotësuar në skaner për të hedhur votën tuaj. Skaneri pranon fletët e votimit në çdo drejtim dhe lexon të dyja anët. Skaneri do t’ju njoftojë kur vota juaj të jetë hedhur.

MOS HARRONI:

Kthejeni fletën e votimit nga ana tjetër! Mund të ketë udhëzime dhe/ose propozime në fletën e votimit për të cilat duhet të votoni në pjesën e pasme.

Ngjyrosni të gjithë hapësirën e ovalit. Mos përdorni një “x”, një “✓”, ose mos e rrethoni hapësirën e ovalit.

Votoni vetëm për një person, përveçse nëse udhëzoheni ndryshe Në kolonën e parë të çdo rreshti, fleta e votimit do të tregojë se sa zgjedhje keni. Në shumicën e rasteve, do të thotë “Votoni për NJË”, por në disa raste mund të thotë “Votoni për cilindo DY”, “Votoni për cilindo TRE”, etj. Kjo do të thotë se mund të votoni deri në atë numër kandidatësh. Ju lutemi lexojeni fletën e votimit me kujdes që të mos votoni për më shumë ose më pak opsione seç lejohet.

Ju mund të votoni për një kandidat të shkruar manualisht. Mund të votoni për një kandidat që nuk është i listuar në fletën e votimit duke plotësuar hapësirën ovale për kandidatët e shkruar manualisht dhe duke shkruar emrin e tyre në hapësirën e parashikuar.

Sigurohuni të votoni për çdo zyrë dhe për çdo pyetje në fletën e votimit. Rishikoni fletën tuaj me kujdes përpara se ta skanoni. Sigurohuni që keni votuar për çdo garë dhe çdo propozim në fletën e votimit.

Problemet dhe Zgjedhjet

Bëra një gabim gjatë shënimit të fletës sime të votimit.

Nëse votoni personalisht, makineria e votimit do t’ju njoftojë gjatë skanimit nëse keni renditur disa kandidatë me të njëjtën rëndësi ose nëse dorëzoni një fletë votimi plotësisht të zbrazët. Nëse bëni një gabim, mund t’i kërkonti një punonjësi të qendrës së votimit një fletë të re votimi. Makineria e votimit nuk do t’ju njoftojë nëse anashkaloni renditjet ose nëse renditni të njëjtin kandidat disa herë, pasi vota juaj për zgjedhjen kryesore do të llogaritet gjithsesi në ato raste.

Shkrimi është shumë i vogël, nuk mund ta lexoj fletën e votimit prej letre.

Do të ketë në dispozicion fletë zmadhuese. Gjithashtu, mund të kërkonti të përdorni një Pajisje për Shënimin e Fletës së Votimit.